

PERMBLEDHJE E RVNM-SE TE AKTIVITETIT

BLEKTORIA, ID 7.8 a. RRITJE INTENSIVE E SHPENDEVE NE
NJE INSTALIM

PRODHIMI I USHQIMEVE DHE PIJEVE DHE VEPRIMTARITE
E LIDHURA ME TO, ID.7.7.a.THERTORE

SUBJEKTI : “HYMAR GROUP”SH.P.K Korce

ADMINISTRATOR: Z. Marenglen MYRTOLLARI

NUIS/NIPT L64025002F

ADRESA : Korçe, Voskop, Rruga Korçe-Voskop, Km-3 te, Zona
Kadastrale 1816, Nr.pasurise 156/17

PËRMBAJTJA

HYRJE.....

KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV I KRYERJES SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....

Qëllimi dhe Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Procedura e miratimit mjedisor të projekteve dhe veprimtarive.....

Çështjet me rëndësi mjedisore

RAPORTI TEKNIK I VEPRIMTARISË

Qëllimi i aktivitetit.....

Vendodhja e impiantit dhe thertoresh

Objektet dhe strukturat e projektit

Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe linjës teknologjike

Përshkrimi i procesit teknologjik.....

Përshkrimi i linjës teknologjike

Infrastruktura e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, rrugët ekzistuese të aksesit apo nevoja për hapje të rrugëve të reja

Lëndët e para që do të përdoren për ndërtim dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji).....

Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit.....

Informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret.....

Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit përfshirë sasinë e nevojshme të ujit, energjisë dhe mënyrën e sigurimit të tyre.....

Aktivitete të tjera që mund të nevojiten si pasojë e veprimtarisë

Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për veprimtarinë sipas legjislacionit në fuqi

Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar

PËRSHKRIMI I GJENDJES SË MJEDISIT NË ZONËN E PROJEKTIT.....

Përshkrimi i karakteristikave të mjedisit fizik

Gjeologjia

Informacion Mjedisor për projektin e rritjes dhe therjes se pulave

Gjeomorfologjia

Tokat

Ujërat

Klima.....

Mjedisi biologjik

Flora në zonën e impiantit

Fauna në zonën e impiantit

Informacion për praninë e zonave të mbrojtura në afërsi të projektit apo praninë e vlerave kulturore të mbrojtura

Mjedisi social dhe ekonomik.....

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS

Metodika e kryerjes së Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis

Analiza e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të fazës operacionale të impiantit

Ndikime të mundshme negative në mjedis të fazës operacionale të impiantit

Përshkrim i shkarkimeve të mundshme në mjedis si, ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve.....

Kohëzgjatja e ndikimeve të mundshme (të përkohshme, të përhershme, sipas procesve teknologjike etj.).....

Shkalla e shtrirjes hapsinore të ndikimeve negative (distanca nga burimi i ndikimit, ku shfaqet pasoja e ndikimit dhe zonat e banuara të ndikuara).....

Mundësia e kthyeshmërisë së pasojave të ndikimeve negative dhe kthimin e mjedisit tëndikuar në gjendjen e mëparshme

Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar.....

PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT DHE MASAT E PROPOZUARA PËRZBUTJEN E
NDIKIMEVE....

Përmbajtja e Planit të Menaxhimit të Mjedisit.....

Masat për zbutjen e ndikimeve në fazën e operimit

Masat për zbutjen e ndikimeve në ajër

Masat për kontrollin e ndotjes në ujëra

Masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në tokë

Masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në biodiversitet.....

Masat mbrojtëse ndaj rreziqeve nga patogjenët.....

Masa të tjera

Përmbledhje masave për mbrojtjen e mjedisit

Përmbajtja e Planit të Përballimit të Emergjencave

Zjarri

Informacion Mjedisor për projektin e Mbarështimit të Pulave për prodhim vezësh –

Epidemitë

Plani i Përfshirjes së Grupeve të Interesuara dhe Trajtimi i ankesave.....

PROGRAMI I MONITORIMIT TË MJEDISIT.....

Qellimi: Shoqëria “HYMAR GROUP”SH.P.K. synon të ushtrojë veprimtarinë në fushën e rritjes intensive të pulave ose zogjve dhe në thërrjen e tyre. Për zhvillimin e veprimtarisë kompania ka ndërtuar dhe vënë pjesërisht në operim një impiant, kapaciteti i projektuar i të cilit është 40000 krerë. Instalimi përbëhet nga kater kabanone. Aktualisht janë në funksionim të kater kabanonet. Ka përfunduar së rindërtuari edhe pjesa kryesore e infrastrukturës ndihmëse si magazina, sistemi i mbledhjes së ujërave, kabina elektrike, pusi i furnizimit me ujë, thertorja etj. Në zbatim të legjislativës në fuqi, për zhvillimin e aktivitetit të propozuar kompania do të aplikojë për pajisjen me Leje Mjedisore dhe me këtë synim ajo ka kryer procedurën e Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë dhe është në proces të aplikimit për Deklaratën Mjedisore. Subjekti do të ushtrojë aktivitetin për rritje intensive e shpendeve në një instalim. Kete aktivitet subjekti e ka blere së bashku me truallin dhe kabanonet subjektit juridik “UINA”sh.p.k i cili edhe me pare e ka ushtruar kete aktivitet.

Duhet theksuar ky aktivitet në keto ambiente ka vite që është i zhvilluar dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipërmarresit që kanë aktivitetet pranë për rritje intensive e shpendeve në një instalim dhe tregëtimin e tyre (Pulari për rritjen intensive të shpendeve). Territori i zgjedhur është mjaft i pershtatshëm për funksionimin e këtij aktiviteti duke paraqitur disa perparaesi si:

- Sistem perspektiv të furnizimit me lende e pare
- Sistem perspektiv të furnizimit me energji elektrike.
- Mundësi për zbatimin korrekt të projektit personi Juridik “HYMAR GROUP”SH.P.K
- Mundësi për ngritje të sistemit të kanalizimeve dhe shkarkimeve
- Ka qene kabanone ekzistuese dhe ka patur të njejtin funksion

Pozicioni i rritjes intensive të shpendeve dhe tregëtimin e tyre ka të zgjidhura disa nga problemet që lidhen me anën funksionale si.

- ♣ Largesia të mjaftushme nga vendet e banuara.
- ♣ Pranë fuqisë punetore.

Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Gjatë hartimit të raportit Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë së propozuar u konsultuan dokumente mbi politikën shtetërore të mbrojtjes së mjedisit, legjislativi mjedisor dhe institucional shqiptar, i përgjithshëm dhe ai që lidhet në veçanti me projektin si dhe akte normative dhe standartet industriale për veprimtarinë e propozuar.

- Ligji kuadër nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- Ligji nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
- Ligji nr.9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Ligji nr.8906 datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”.
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Ligji nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

- Ligji nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”. Njëkohësisht, janë konsultuar aktet e mëposhtëm të cilët përcaktojnë standartet aktualë për mbrojtjen e biodiversitetit, shkarkimet në ajër, në ujëra dhe menaxhimin e mbetjeve:
- Vendim nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- VKM nr.229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”.
- VKM nr.371 datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.
- VKM nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- Vendim nr.435 datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM nr.676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”.
- VKM nr.686 datë 29.07.2015“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”.
- VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
- Udhëzim nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.

Procedura e miratimit mjedisor të projekteve dhe veprimtarive Në zbatim të legjislacionit në fuqi, projektet me ndikim në mjedis ndjekin procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe miratohen përpara fillimit të zbatimit të tyre në terren. Dokumenti kryesor në të cilin bazohet miratimi mjedisor i projektit është Raporti i VNM. Mbasi të jetë hartuar Draft Raporti, ai prezantohet për grupet e interesit në Dëgjesën Publike përkatëse. Vërejtjet, sugjerimet dhe komentet e grupeve të interesuara përfshihen në raportin final, i cili bashkë me dokumentacionin tjetër të kërkuar, paraqitet pranë Ministrisë së Mjedisit e cila e përcjell për shqyrtim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në varësi të projektit AKM mund të shprehet me Vendim/Deklaratë Mjedisore, e cila përfaqëson dokumentin orientues për autoritetet planifikues dhe i paraprin procedurës për paisjen me Leje Mjedisore të aktivitetit. Bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, referuar kapacitetit të projektuar, aktiviteti përfshihet në Shtojcën 1, pika 17/a, dhe si i tillë i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis.

Çështjet me rëndësi mjedisore Bazuar në natyrën e veprimtarisë, ndër çështjet kyç mjedisore që ka konsideruar raporti VNM veçohen:

- Statusi i zonës në të cilën do të zbatohet projekti;
- Menaxhimi i mbetjeve të aktivitetit, veçanërisht i mbetjeve organike (manure/plehu, pula të ngordhura);
- Distanca nga zonat e banuara për të vlerësuar ndikimin e mundshëm në komunitet (kryesisht aromat).

Ne afersi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkollë, vepra arti, argjaturë, linje elektrike dhe linje uji që mund të demtohen nga zhvillimi i aktivitetit. Përmirësimi urban i kësaj zone, e cila ka patur zhvillime mjaft të mëdha e të shpejta, urbanistike dinamike kohët e fundit vazhdon të tërheqë mjaft interesin e subjekteve privatë. Hapsira para ndërtesës së për rritje intensive e shpendëve në një instalim është e sistemuar, duke bërë të mundur realizimin e një imazhi pamor mjedisor shumë cilësor, çka dhe ka ndikuar në përmirësimin e pamjes vizuale. Përveç interesit ekonomik, investitori ka bërë rregullime, sistemime të sheshit para objektit, rrugëve, ka krijuar hapsira të gjelbërta. Aktiviteti për rritje intensive e shpendëve në një instalim është një ndërtesë me hapësirë e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Aktiviteti për rritje intensive e shpendëve në një instalim ku zhvillohet aktiviteti është me një kat, dhe e konfirmuar nga pushteti lokal dhe orinstitucionet e tjera.

Numri i krerëve për të gjithë projektin e kabanonëve të cilin kemi synim të arrijmë është 40000 shpende. Në të operojnë teknologjia dhe instalimet përkatëse, ambjentet e shërbimeve mbështetëse dhe parkimi. Për rritje intensive e shpendëve në një instalim dhe tregtimin e tyre përdoren ushqime të certifikuar. Kabanonet pastrohen gati çdo ditë. Për të gjitha mbetjet që dalin nga larja dhe pastrimi i kabanonëve futen në një gropë prej betoni dhe prej këtyre merren me bote dhe pleherohet tokat e mbyjlla me jonxhe. Aktiviteti tregtar i Shoqërisë "HYMAR GROUP" SH.P.K është rritja dhe tregtimi i shpendëve kryesisht pula. Tregu i produkteve blegtorale është një treg në rritje dhe për pasojë ka gjithmone e me shumë të pranishme konkurrencën. Rritja e shpendëve ka 4 kabanone me kapacitet 10000 krerë. Konkretisht shoqëria "HYMAR GROUP" SH.P.K ka një biznes të konsoliduar.

Struktura e pronësive. Kompleksi i rritjes intensive të shpendëve dhe thërrjes së tyre të subjektit "HYMAR GROUP" SH.P.K është i ndërtuar në një sipërfaqe tëke prej 7745m² dhe ndërtimi rreth 3000m² e cila është pronë e shoqërisë "HYMAR GROUP" SH.P.K. Shoqëria "HYMAR GROUP" SH.P.K ka të vetat objektet si kabanone të rritjes së zogjve, si dhe godinë e thërrësës së zogjve.

Planimetria e vendndodhjes së projektit, ku në të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së funksionimit të veprimtarisë;

Kompleksi 1 Kat me 4 kabanone për rritjen e thërrjes së shpendëve është ndërtuar në fshatin Goskove Posht, Njësi Administrative Voskop, Bashkia Korçë. Zona ndodhet 100 m larg rrugës Korçë Voskop, dhe në të gjithë anët kufizohet me tokë bujqësore. Zona në studim ku është kompleksi 1 Kat për rritjen e shpendëve nuk ka veprimtari ekonomike të natyrë tjetër që mund të çënohen gjatë fazës së funksionimit të instalimit. Distanca nga qendrat e banuara dhe burimet ujore të zonës në studim janë 1 km dhe 50m larg perroit të drevnices. Zona kadastrale është 1816, Nr.Pasurisë 156/69, Indeksi Hartes K-34-126-(40 – B), dhe kufizohet nga koordinatat e mëposhtme.

sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE:

Koordinatat e pikave te rrethimit te objektit:

Pika	X	Y
1	4477586.20	4498517.63
2	4477564.45	4498458.69
3	4477767.18	4498399.07
4	4477781.44	4498460.07

Koordinatat e objektit **-1-**

Pika	X	Y
1	4477586.20	4498517.63
2	4477570.15	4498464.55
3	4477584.44	4498461.57
4	4477600.48	4498513.07

Koordinatat e objektit **-2-**

Pika	X	Y
1	4477609.78	4498510.55
2	4477593.05	4498457.02
3	4477605.29	4498454.04
4	4477621.34	4498507.80

Koordinatat e pikes se shkarkimit te thetores:

Pika	X	Y
1	4477780.99	4498460.30

Koordinatat e objektit **-3-**

Pika	X	Y
1	4477636.76	4498502.56
2	4477620.49	4498449.02
3	4477633.64	4498446.72
4	4477649.91	4498498.45

Koordinatat e objektit **-4-**

Pika	X	Y
1	4477659.21	4498496.38
2	4477642.72	4498444.66
3	4477656.32	4498441.23
4	4477670.78	4498492.51

Koordinatat e objektit **-A-**


Pika	X	Y
1	4477756.95	4498467.15
2	4477754.42	4498456.76
3	4477777.32	4498448.32
4	4477780.99	4498460.30

Koordinatat e pikes se shkarkimit

Pika	X	Y
1	4477628.03	4498503.15



Prone e z. Marenglen MYROLLARI
Sip. Totale 7745m²



KUFIZIMET:
V. 156/47
L. 427
J. 156/68
P. 156/68





Burimet njerezore te subjektit “HYMAR GROUP”SH.P.K ka te punesuar 6 -10 punonjes. Puntoret qe jane te punesuar per te gjithë vitin jane ata qe punojne ne kompleksin e rritjes dhe therjes se shpendeve. Fuqia puntore vjen nga zonat perreth kompleksit te rritjes se zogjve dhe thertores. Puntoret kane interesin e ruajtjes se mundesise se punesimit (ne kete zone eshte e veshtire te punesohesh ose te vetepunesh, sepse eshte zone e “izoluar” nga pjesa urbane), por edhe shoqeria “HYMAR GROUP”SH.P.K ka interes te kete te njejten fuqi puntore sepse ka investuar ne kualifikimin e tyre.

Shoqeria “HYMAR GROUP”SH.P.K nepermjet ketij investimi synon mbi te gjitha qe te kompletoje te gjithë biznesin e vete me te gjitha normat dhe standartet qe aplikohen ne feramat blegtorale perendimore. Ne ditet e sotme projekti te cilin ne paraqesim i ofron shpendeve te gjitha kushtet kryesore dhe optimale per rritje dhe therjen e shpendeve si: drite, uje, ajer i fresket dhe i paster si dhe pastertia brenda ne kompleks. Te gjitha keto do ti argumentojme me poshte per te dhene nje ide me te qarte te investimit. Ambientet e Punes dhe ato sanitare pastohen jo me pak se nje here ne dite dhe ne raste te vecanta me

shume, dhe mbas cdo pastrimi behet dizifektimi i saj. Uji qe ne perdorim vjen nga ndermarja e ujesjellesit te Uk-Korce dhe kemi kontrate te rregullt me kete ndermarrje shtrirje fizike me impakt pozitiv visual nga rruga.

Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

Lendet e para kryesore qe do te perdoren ne instalim per rritjen e shpendeve gjate fazes se funksionimit jane: Zogjte 24 oresh ; soje ; miser ; vaj ushqimor i paperpunuar ; lende minerale (pluhur mermeri etj) uje.

Nje pike e rëndesishme ne realizimin me sukses te kesaj veprimtarie eshte dhe ushqimi. Perberesit kryesore jane misri dhe soja. Rreth 70% te ushqimit e perben misri, soja perben 28% dhe pjesa tjeter perbehet nga vaji ushqimor i paperpunuar, karbonat dhe nukleusi qe i nevojitet zogut per te marre sasine e duhur te proteinave, energjise dhe gjithcka qe nevojitet per nje rritje te shendetshme dhe pa probleme. E rëndesishme nuk eshte vetem perberja e ushqimit, por edhe madhesia e kokrres se ushqimit. Ne periudhen e pare deri ne 21 dite kokrra e ushqimit duhet te jete shume e vogel, me pas ushqimi behet me i ashper ne menyre qe zogu ta konsumoje pa problem. Lenda e pare eshte e gatshme dhe do te sigurohet nga importi dhe tregu vendas dhe do t'u serviret ne menyre automatike lokaleve te zogjve nepermjet bunkerit te ushqimit. Paneli kontrolli nepermjet sensoreve qe do te instalohen ne cdo lokal do te beje rregullimin e sasise se ushqimit te nevojshem per cdo faze te rritjes se zogjve, sipas dozaturave te caktuara. Detaje mbi lëndët e para Nr. Materiali Sasia që zakonisht magazinohet (t)

1. Soje Rreth 10 ton/jave
2. Miser
3. Vaj ushqimor i paperpunuar
4. Lende minerale
5. Uje 10 m³ /dite

Thertorja: procesi i therjes kalon ne disa faza si procesi i pranimit te zogjve ose pulave, therja me konik, zjerja, rjepja, pastrimi, larja, kullimi, paketimi, mbajtja ne frigorifer(18-40^{0C}), tregetimi.

Aktiviteti zhvillohet ka kohë që ekziston dhe nuk ka patur asnjë problem me komunitetin dhe nuk ka shkaktuar probleme të ndotjes së mjedisit. Me këtë raport sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian. Aktiviteti jone ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone. Ne Kapanonet per rritjen intensive te shpendeve jane punesuar 6-10 punonjes te perhershem. Nga pikpamja sociale, zhvillimi i ketij aktiviteti eshte faktor per zbutjen e papunesise dhe burim te ardhurash per familjet qe jetojne duke punuar ne kete shoqeri. Në territorin përreth objektit infrastruktura inxhinjrike është në gjendje të mirë, rrugët janë të shtruara, sipërfaqet e lira janë të gjelbëruara me pemë dekorative, sistemi i kanalizimeve, rrjeti elektrik dhe ujësjellësi janë në gjendje të mirë. Arsyet për përzgjedhjen e këtij vendi për të kryer aktivitetin janë: - Aktiviteti kapanone per rritjen intensive te shpendeve ndodhet në një vend

stratejik për zhvillimin e aktivitetit. - Aktiviteti kapanone për rritjen intensive të shpendeve ndodhet në një zonë që nuk dëmton Komunitetin. - është me dalje në rrugë si dhe ekziston infrastruktura e nevojshme: rrugë, energji, ujë, sistem kanalizimesh, etj. - është në largësi nga komuniteti.

Kapanoni për rritjen e shpendeve Brenda secilit kapanon instalohen kafazët dhe infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e ciklit të prodhimit. Kafazët janë të organizuar në bateri, ku gjithashtu janë të instaluar: linja e ushqimit, linja e shpërndarjes së ujit, linja e grumbullimit të vezëve dhe transportimit të tyre në repartin e paketimit jashtë kapanonit, dhe, linja e mbledhjes dhe largimit jashtë kapanonit të manureve.

Të gjitha këto procese, janë të automatizuara dhe kontrollohen me ndihmën e një sistemi elektronik dhe paneli të vendosur brenda kapanonit. brenda secilit kapanon është vendosur, ndricimi, Linja e shpërndarjes së ushqimit, shpërndarja e ushqimit nëpër kafazë realizohet në mënyrë automatike. Kanalet e ushqimit janë të lidhur me karrelat lëvizëse, me ndihmën e të cilave realizohet shpërndarja e ushqimit për çdo kafaz. Shpërndarja e ushqimit bëhet sipas një programi të caktuar dhe miratuar dhe realizohet ndërmjet orës 8 të mëngjesit dhe 9 të darkës dhe në porcione të caktuara. Karrelat e ushqimit lëvizin përgjatë secilës bateri duke dhënë sasinë e kërkuar të recepturës së ushqimit për çdo kafaz. Dozimi realizohet në mënyrë automatike nëpërmjet dozatorëve që ka secili karrel shpërndarës. Karrelat vihen në lëvizje me energji elektrike.

Edhe shpërndarja e ujit nëpër kafazë realizohet në mënyrë automatike. Brenda secilit kapanon është e vendosur depozita e ujit, nga ku bëhet shpërndarja me ndihmën e sistemit me “rubineta”. Numri i rubinetave përcaktohet në varësi të numrit të zogjve. Në secilën “rubinetë” furnizohet sasia e përlllogaritur. Furnizimi i depozitave bëhet nga linja kryesore e furnizimit me ujë të impiantit (pusi), ndërsa dozimi bëhet mbi bazën e ngarkesës që ka çdo kafaz (numrit të pulave).

Përshkrimi i mjedisit fizik të zonës

Ndikimet në mjedis

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme

- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.

- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta, ujerat e larjes se stalles dhe ambienteve dekantohen.

- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë. - Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.

- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme. - Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.

- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Niveli i zhurmës nuk i kalon 55-60 dB(A) gjatë punës në këto stalle. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.

- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës

- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.

- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.

- Trafiku rrugor. Gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.

- Projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, naftë dhe gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. nuk do të ndikohen nga aktiviteti i stalles. Aktiviteti kapanone për rritjen intensive të shpendeve pastrohet rregullisht brenda dhe jashtë.

Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Ky nivel zhurmash nuk ndikon në shëndetin e punonjësve dhe as në shëndetin e personave që punojnë në ambientet përreth. Punonjësit e këtij aktiviteti për rritjen intensive të gjedhit janë udhëzuar të bëjnë një përdorim të duhur të ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike. Ata janë tepër të kujdesshëm për një përdorim sa më të përshtatshëm të këtyre dy burimeve.

Mbetjet : kryesisht janë puplat, të brendeshmet, uji, plehu së bashku me kashten

Edhe jashtëqitjet e pulave (manuret) mbledhen në. Me ndihmën e punonjësve dhe pajisjeve, manuret transportohen në vaskat e mbledhjes së tyre, të vendosura në fund të çdo baterie. Që këtej, nëpërmjet një kanali me një zinxhir në formë transportieri nxirren jashtë kaponit për në gropën e posaçme në pritje të largimit nga impianti. Me kapacitetin aktual të impiantit, sasia e manureve është 2 ton ($1m^3$) në ditë dhe merret nga fermerët e vegjël të zonës që e përdorin për pleh. Te gjitha këto mbetje gjejnë përdorim: të brendeshmet e pulave melcite, kokat dhe stomaku shiten tregtohen nëpër lokale. Te brendeshmet e pulave (zorret) përdoren për kafshet ose groposen. Plehu gjen përdorim në bujqësi së bashku me ujin, puplat kalben dhe përdoren për pleh.

Paneli i kontrollit (automatik) I gjithë cikli brenda kaponëve zhvillohet në mënyrë automatike dhe kontrollohet nëpërmjet panelit të kontrollit. Në secilën bateri janë të instaluar sensorë ndjeshmërie që marrin dhe dërgojnë sinjale në panelin e kontrollit. Ky i fundit është i lidhur me sistemin kompjuterik, nëpërmjet sistemit të të cilit menaxhohet dhe kontrollohet i gjithë impianti. Secila prej baterive funksionon dhe kontrollohet më vetë, duke bërë të mundur që çdo difekt apo nevojë për remont të mos pengojë funksionimin e të tjerave. E gjithë veprimtaria e impiantit mund të kontrollohet nëpërmjet telekamerave dhe programeve kompjuterikë përkatës nga menaxherët e kompanisë.

Silose e ushqimit Pjesë shumë e rëndësishme e impiantit është silosi i ushqimit. Brenda tij garantohe mbajtja e ushqimit në kushte konstante të temperaturës, lagështisë, rrezatimit e të tjerë faktorë atmosferikë që ndikojnë në cilësinë e tij. Kapaciteti i silosit është 7 ton ushqim dhe është i instaluar mbi një mbajtëse

të mbërthyer në platformën prej betoni të impiantit. Prej këtej ushqimi shpërndahet nëpër kapanonet me ndihmën e një sistemi tubash. Ushqimi dërgohet nëpër kapanone në mënyrë automatike pas marrjes së sinjalit nga paneli i kontrollit, i cili sinjalizohet nga sensori i vendosur përkatës brenda kapanonit.

Masat mbrojtëse për punonjësit Punëtorët janë të pajisur me librezat shëndetësore përkatëse. Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që punojnë në magazinën e perpunimit të ullirit realizohet duke zbatuar:

- Rregulloren e sigurimit teknik
- Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektoriati i Higjenës së Punës
- Garancinë e produkteve që ruhen në kapanone për rritjen intensive të shpendeve si të padëmshme për shëndetin e punëtorëve në të gjitha fazat e punës me to.

Informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret; Ne fazën e projektimit dhe pozicionimit të projektit “Kompleks 1 Kat për rritjen e shpendeve” me sipërfaqe 7745 m² janë marre në konsideratë kushtet klimaterike të zonës, gjeologjia, tipologjia e ndertimeve dhe pozicionimi i tyre në raport me projektin në zhvillim, distanca nga objektet e banura dhe lidhjen e tij me infrastrukturën ekzistuese të zonës, pronesia mbi pasurinë që do të zhvillohet.

Alternativa 1 Në alternativën e parë të projekt – idesë është marre në konsideratë distanca e objektit të ri në raport me objektin ekzistues me një distancë ndërmjet tyre prej 7.5 m dhe i gjithë ndertimi zhvillohet në pasurinë në pronësi të familjes Myrtollari. Vetë tjetërsimi i pasurisë në pronësi të familjes Myrtollari, të kondicionon në zhvillimin e mëtejshëm të saj për ndertimin e kompleksit 1 kat për rritjen e shpendeve. Objektet kanë shtrirje paralele dhe me shfrytëzim optimal të instalimeve.

Alternativa 2 Në alternativën e dytë të projekt – idesë, është marre në konsideratë distanca e objektit nga objektet ekzistues dhe nga objektet e tjera me të afërta. I gjithë ndertimi zhvillohet në një pasuri të familjes. Objektet janë në seri dhe me kushte të mira për shfrytëzimin optimal të tyre. Gjithashtu do të kenë një shtrirje fizike me impakt pozitiv vizual nga rruga.

Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

Lendet e para kryesore që do të përdoren në instalim për rritjen e shpendeve gjatë fazës së funksionimit janë: Zogjtë 24 orësh ; sojë ; misër ; vaj ushqimor i paperpunuar ; lende minerale (pluhur mermeri etj) uje.

Një pikë e rëndësishme në realizimin me sukses të kësaj veprimtarie është dhe ushqimi. Përberësit kryesore janë misri dhe soja. Rreth 70% të ushqimit e përben misri, soja përben 28% dhe pjesa tjetër përbehet nga vaji ushqimor i paperpunuar, karbonat dhe nukleusi që i nevojitet zogut për të marrë sasinë e duhur të proteinave, energjisë dhe gjithçka që nevojitet për një rritje të shëndetshme dhe pa probleme. E rëndësishme nuk është vetëm përberja e ushqimit, por edhe madhësia e kokrës së ushqimit. Në periudhën e parë deri në 21 ditë kokra e ushqimit duhet të jetë shumë e vogël, me pas ushqimi bëhet me i ashpër në mënyrë që zogut ta konsumojë pa problem. Lenda e parë është e gatshme dhe do të sigurohet nga importi

dhe tregu vendas dhe do t'u serviret ne menyre automatike lokaleve te zogjve nepermjet bunkerit te ushqimit. Paneli kontrolli nepermjet sensoreve qe do te instalohen ne cdo lokal do te beje rregullimin e sasise se ushqimit te nevojshem per cdo faze te rritjes se zogjve, sipas dozaturave te caktuara. Detaje mbi lëndët e para Nr. Materiali Sasia që zakonisht magazinohet (t)

1. Soje Rreth 10 ton/jave
2. Miser
3. Vaj ushqimor i paperpunuar
4. Lende minerale 5.

Uje 10 m³ /dite

♣ **Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;** Ne funksion te instalimeve per rritjen dhe therjen e shpendeve, eshte ndertuar kabina e rojeve, zyrat per administraten dhe rruga komunikuese e objekteve me rrugen dytesore. Aktivitete të tjerë të mundshëm janë ato të transportit, të lëndës së parë (ushqimit) dhe largimi i manureve dhe mbetjeve të tjera, të cilat do të kryhen nga kontraktorët përkatës.

Informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;

Per zhvillimin dhe ushtrimin e projektit per rritjen intensive te shpendeve, subjekti duhet te pajiset me lejet dhe licencat e meposhtme: - Deklarate Mjedisore - Leje Mjedisori Tipi B per vendosjen ne funksionim te instalimit per rritjen intensive te shpendeve Kodi III.1.B (pa afat) nga Ministria e Mjedisit - Licence Mbareshtim i kafsheve dhe shpendeve ne fermat agroblegtorale te medha (pula - zogj) Kodi II.3.A (pa afat) nga Ministria e Bujqesise - Tregtimi me shumice te kafsheve te gjalla si: (Pula dhe zogj) II.3.C (pa afat) nga Ministria e Bujqesise

Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit. Subjekti eshte ne procedura e siper per pajisje me Deklarate Mjedisore dhe Leje Mjedisore te tipit B, si rrjedhoje per kete instalim, nuk disponojme leje mjedisore te re por eshte leja ekzistuese e subjektit UINA per te cilen I ka mbaruar afati ligjor dhe n uk eshte bere transferimi i saj.